



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 44 regjistër (JR)
Datë 18.09.2019

Nr. 15 i vendimit
Datë 10.07.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Luan Daci	Relator
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim më datë 10.07.2020, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonci Petkovic, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 162, datë 19.06.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2, F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik Florian Ballhysa, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, mbrojtur në gjykim nga avokatja Romina Zano, e cila kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dhe dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Luan Daci, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte funksionin e prokurores pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
 - 1.1. Çështja që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, u shqyrtua me përparësi në kohë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), për shkak të kandidimit për funksionin e prokurores në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 11 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (në vijim “ligji nr. 95/2016”).
2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), përkatësisht sipas neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, kanë kryer procedurat e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana.
3. Në përfundim të veprimeve verifikuese, ILDKPKI-ja, pasi ka kryer procedurën e kontrollit të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit *vetting* (në vijim “deklarata *vetting*”), të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, në datën 27.01.2017, ka përgatitur aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimi nr. {***} prot., datë 04.05.2018, sipas të cilit ka konstatuar se:
 - a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - ç) nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe
 - d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
4. Në përfundim të kontrollit të figurës, DSIK-ja, pas përfundimit të procedurave referuar deklaratës për kontrollin e figurës të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, në datën 27.01.2017, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës nr. {***} prot., 30.10.2017¹, sipas të cilit formulari i deklarimit ishte i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore. Për DSIK-në, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, ishte e përshtatshme për vazhdimin e detyrës dhe bazuar, në informacionet e ardhura nga institucionet e verifikimit, si: prokuroria, SHISH-i dhe SHÇBA-ja, DSIK-së i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit kishte pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si të deklaruara apo paraqitura nga ajo vetë në deklaratën për kontrollin e figurës, dhe se nuk administroheshin prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat të mund të ngriheshin dyshime të arsyeshme

¹ Raporti sekret mbi kontrollin e figurës nr. {***}, prot. 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, rezulton i deklasifikuar me vendimin nr. {***} datë 14.05.2019, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret” (KDZH).

për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

5. Gjithashtu, në përfundim të vlerësimit të aftësive profesionale, KLP-ja, pasi ka marrë në shqyrtim formularin e vetëdeklarimit profesional të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, në datën 27.01.2017, ka përgatitur raportin nr. {***} prot., datë 15.04.2019, për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 162, datë 19.06.2019, ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë”, duke arritur në konkluzionet e mëposhtme.
 - a) Lidhur me kriterin e pasurisë nën hetimin e thelluar e të gjithanshëm, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit kishte plotësuar me vërtetësi dhe saktësi deklaratën “vetting” dhe kishte pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në përputhshmëri të plotë me deklaratimet periodike, si dhe të mbështetur në dokumentacion ligjor që në momentin e dorëzimit të deklaratës “vetting” në ILDKPKI, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016.
 - b) Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, kishte arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
 - c) Për kriterin profesional, referuar Aneksit të Kushtetutës, nenit E, ligjit nr. 84/2016, kreu VI, Komisioni vlerësoi se subjekti kishte përmbushur kushtet ligjore të pikës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

7. Kundër vendimit të Komisionit paraqiti ankim Komisioneri Publik (në vijim “Komisioneri”), i cili mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, fillimisht kërkoi që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merreshin në konsideratë nga ana e Kolegjit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave, për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosej:
 - a) Ndryshimi; ose
 - b) Lënia në fuqi e vendimit nr. 162, datë 19.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
8. Sipas Komisionerit, rezultatet e hetimit nga ana e Kolegjit, mbi rrethanat e ndërthurura me njëra-tjetrën, dhe që lidhen më të tria kriteret e rivlerësimit, eventualisht do të provonin nëse veprimet apo mosveprimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, kanë cenuar rregullat etike profesionale, figurën e magjistratit apo nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur ose jo burime të ligjshme të të ardhurave dhe, në vlerësim tërësor të procedurave, do të mund të vendosej mbi vlerësimin përfundimtar për konfirmimin ose jo në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

8.1. Në ankimin e paraqitur, Komisioneri ka ngritur pretendime në drejtim të ligjshmërisë së aplikimit për përfitimin e statusit si i pastrehë, me qëllim blerjen e apartamentit me sip. 110,11 m², {***}, Tiranë, të deklarimeve mbi vendbanimin dhe vendqëndrimin², të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit dhe etikës lidhur me Bashkinë Fier ose zyrtarë të saj, si dhe me {***} (në vijim “{***}”) ose punonjës të saj, të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe z. K. K., si dhe të kursimeve nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe të z. K. K., si burim krijimi të pasurisë apartament 110,11 m², {***}, Tiranë.

9. Nëpërmjet bisedimeve përfundimtare të datës 07.07.2020, Komisioneri, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës, neneve 65, 66, pika 1, germa “a”, kërkoi: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 162, datë 19.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana”.

9.1. Sipas Komisionerit, aktet e administruara nga Kolegji përmbushën nevojat për hetim të mëtejshëm mbi verifikimin e situatës juridike të pahetuar, për të identifikuar nëse subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, kishte kryer ose jo veprime procedurale hetimore, në drejtim të evidentimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit dhe funksionit të magjistratit/prokurorit, cenimit të etikës profesionale³.

9.2. Sipas Komisionerit, në referencë të këtij shkakut parësor të ankimit, aktet e dosjes gjyqësore penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, vendimi nr. {***}, datë 28.05.2015, ishin të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së magjistratit prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, gjatë periudhës që zgjatën hetimet 2012 - 2014, duke mos cenuar etikën profesionale në kryerjen e detyrës.

9.3. Ky përfundim, sipas Komisionerit, bazohet në verifikimin e akteve të dosjes gjyqësore të administruar gjatë gjykimit nga ky trup gjykues, prej nga prokurorja Manjola Kajana nuk rezultonte të kishte kryer ndonjë veprim procedural në lidhje me hetimin e zyrtarëve të Bashkisë Fier, si dhe nuk kishte mbajtur detyrën e prokurorit drejtues/më të lartë, teksa bashkëshorti i saj listohej për të përfituar nga kjo bashki një kredi me kushte lehtësuese për familjet e pastreha.

9.4. Në lidhje me shkaqet e tjera të ankimit, plotësimi i kriterëve të aplikimit dhe pamjaftueshmëria financiare në vlerën 115000 lekë, si të ndërvarura me shkakun parësor të tij, që lidhej me etikën dhe rivlerësimin profesional të magjistratit⁴, në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, edhe pas hetimit të kryer nga Kolegji, Komisioneri nuk i rezultoi se provoheshin të ishin të tillë, që të shërbenin si shkaqe për marrjen e masës së shkarkimit.

² Kontradiktore, sipas Komisionerit.

³ Sipas Komisionerit, vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, e ka konstatuar rëndësinë e këtij episodi për vijimin e karrierës së saj profesionale, pasi në parashtrimet e seancës të datës 06.03.2020, ka parashtruar se edhe pse Komisioni nuk e kishte hetuar këtë çështje, ajo vetë kishte administruar shkresën nr. {***} prot., datë 07.06.2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier, për të vërtetuar mospërfshirjen e saj në hetimin e këtij procedimi penal, por duke mos e dorëzuar këtë akt, në mungesë të kalimit të barrës së provës nga ana e Komisionit.

⁴ Neni 61/4 i ligjit nr. 84/2016.

9.5. Të pabazuara rezultojnë, sipas Komisionerit, pretendimet e ngritura nga denoncuesit, z. T.D. dhe znj. D.M., për veprime të subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, në kundërshtim me ligjin, pasi faktet e pretenduara nga ana e tyre nuk gjejnë mbështetje në situatën ligjore të trajtuar nga ana e subjektit të rivlerësimit në secilin rast.

10. Gjithashtu, në bisedimet përfundimtare, datë 07.07.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, kërkoi: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 162, datë 19.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

10.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, referuar provave të administruara për shkakun e ankimit që lidhet me evidentimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit midis funksionit të prokurores në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (në vijim “PPGjShPF”) në drejtim të përfitimit preferencial në raport me zyrtarët e Bashkisë Fier apo {***}-në, dyshimet e Komisionerit mbi gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit dhe trajtimin preferencial gjatë aplikimit për kredi, apo në momentin e lidhjes së kontratës së disbursuar nga {***}-ja në datën 13.03.2014, bien si të pabazuara në ligj dhe në prova.

10.2. Në lidhje me evidentimin e ligjshmërisë së aplikimit të përfitimit të statusit si i pastrehë, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (në vijim “ligji nr. 9232/2004”), subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, parashtroi se nga aktet e administruara për këtë qëllim, pas një hetimi të plotë dhe objektiv, nuk u arrit të gjendej asnjë indicie që aplikimi për kredi të ketë qenë në kundërshtim me ligjin.

10.3. Në lidhje me evidentimin e deklarimeve të pasakta dhe kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, mbi historikun e vendbanimit dhe vendqëndrimin të saj dhe familjes, subjekti i rivlerësimit parashtroi se ndryshimi i gjendjes civile dhe i zhvendosjes së familjes janë bërë për shkak të nevojave të punësimit, si dhe të dinamikës të jetesës në atë periudhë, të lidhur me rrethanat familjare, dhe në asnjë rast nuk kanë pasur qëllime të përfitimit të padrejtë që, për rrjedhim, të passjellin cenimin e etikës së magjistratit.

10.4. Në lidhje me evidentimin e mungesës së hetimit mbi çështje të tjera të lidhura me burimet e ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, sikurse të ardhurat e bashkëshortit, z. K. K.⁵, dhe depozitat e krijuara ndër vite⁶, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, nuk rezultojnë që të ketë bërë asnjë shkelje të rëndë në raport me deklarin e pasurisë në lidhje me pasuritë, por thjesht të ketë deklaruar me vërtetësi shumat e të ardhurave dhe pasuritë e siguruara ndër vite.

⁵ Nga punësimi pranë {***} ShPK, në vitet 2013 - 2014.

⁶ Sipas subjektit të rivlerësimit, mungesat e evidentuara në ankim, janë pasojë e mosllogaritjes së gjendjes cash të një shume parash të kursyera nga babai i bashkëshortit, z. Th. K..

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

11. Trupi gjykues i Kolegjit, në seancën gjyqësore të datës 06.03.2020, pasi dëgjoi kërkimet e Komisionerit⁷ dhe të subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana⁸, vendosi të çelë hetimin gjyqësor në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, duke lejuar marrjen në cilësinë e provës të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe duke kërkuar informacion shtesë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (në vijim “GjRrGjF”), nga Prokuroria e Përgjithshme, nga Këshilli i Bashkisë Fier (në vijim “KBF”), dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore (në vijim “DRT”) Dibër.
12. Kolegji administroi në cilësinë e provës dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, përkatësisht në datat 03.03.2020, 06.03.2020 dhe 19.03.2020, që do të renditen më poshtë.

A. Dokumentet e paraqitura në datën 03.03.2020⁹

13. Në lidhje me përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, paraqiti në Kolegj vendimin nr. {***}, datë 30.10.2012, të KBF-së, listën emërore të familjeve të pastreha së bashku me kërkesën e datës 21.02.2020 drejtuar Bashkisë Fier, si dhe shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 20.05.2019, të Bashkisë Fier.

13.1. Në përmbledhje të këtyre provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, u vërtetua fakti se familja e z. K. K. rezultonte në listën emërore të familjeve të pastreha, që kishin të drejtë të përfitonin kredi me kushte lehtësuese, por se familja e tij përfundimisht nuk ishte përfshirë në listën e familjeve të pastreha, të cilave u ishte disbursuar kredia.

14. Në lidhje me lindjen e së drejtës për të privatizuar ambientin e banimit nr. {***}, me sip. 41,9 m², në {***}, sektori {***} Durrës, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, paraqiti në Kolegj vërtetimin nr. {***} prot., datë 13.05.2019, të Ndërmarrjes Komunale Plazh (në vijim “NKP”), shkresën e datës 04.04.1995 të Bashkisë Durrës, dhe shkresën nr. {***} prot., datë 13.05.2019, të Bashkisë Durrës.

14.1. Nga këto prova rezultoi se z. Th. K. kishte fituar statusin e personit të pastrehë, në bazë të vendimit të KM-së nr. {***}, datë 29.01.1993, dhe se i ishte dhënë me qira dhe administrim ambienti nr. {***} në {***}, sektori {***} Durrës.

15. Në lidhje me privatizimin e ambientit të banimit me sip. 41,9 m², nr. {***}, në {***}, sektori {***} Durrës, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, sipas shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 13.05.2019, të EKB-së, paraqiti praktikën administrative që i përket kontratës së

⁷ I cili, pasi lexoi parashtrimet, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, kërkoi që shkaqet e parashtruara në ankim të merrshin në konsideratë nga ana e Kolegjit, duke disponuar çeljen e hetimit dhe marrjen e provave përkatëse, sipas kërtimeve të ankimit dhe parashtrësive të paraqitura në datën 06.03.2020.

⁸ Sipas së cilës, referuar dhe provave dhe argumenteve ligjore të paraqitura nga ana e saj, për heqjen e çdo dyshimi apo paqartësie, edhe pse çmonte se hetimi i kryer nga Komisioni për të tria kriteret e vlerësimit ishte i plotë, parashtrroi se ishte plotësisht dakord që për sa u përkte shkaqeve të ngritura në ankim, të riçelëj hetimi gjyqësor sipas nenit 51, shkronja “c” e ligjit nr. 49/2010.

⁹ Shih dokumentet e regjistruara sipas inventarit nr. {***} prot., datë 03.03.2020, dhe procesverbalit nr. {***} prot., datë 03.03.2020.

shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06.2012, të lidhur midis Entit Kombëtar të Banesave (në vijim "EKB"), dhe z. Th. K., z. K. K., znj. Manjola Kajana.

15.1. Në përmbledhje të këtyre provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, rezultoi gjendja familjare e blerësve, z. Th. K., znj. Manjola Kajana dhe z. K. K., të dhënat teknike të ambientit të privatizuar, si dhe pagesa e detyrimeve ligjore sipas mandatpagesës përkatëse që i përkiste kontratës përfundimtare të shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06.2012.

16. Në lidhje me të drejtën e përfitimit të strehimit të z. K. K. në Bashkinë Fier dhe normat e strehimit, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, paraqiti në Kolegj shkresën nr. {***} prot., datë 28.01.2020, të Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (në vijim "MFE").

16.1. Nga prova e mësipërme, rezultoi se familja e subjektit të rivlerësimit, që në momentin e privatizimit të banesës në Durrës, ishte me përbërje 3 persona të rritur dhe 2 kurorë/familje, të cilët banonin në këtë apartament me strukturë garsionerë, me sip. banimi prej 17 m². Mbështetur në pikën 4 të ligjit nr. 9232/2004, kjo banesë në Durrës nuk i plotësonte nevojat për strehim dhe, në këto kushte, familjes së z. K. K. i lindte e drejta për të aplikuar për strehim.

17. Në lidhje me mospërfitimin strehim me kushte lehtësuese nga Bashkia Fier dhe ndryshimin e destinimit të kredisë me {***}-në, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, paraqiti kontratën e kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.06.2013, me {***}-në, ndryshime në kontratën e kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.03.2014, si dhe kontratën e shitjes së pasurisë të paluajtshme me kusht kreditimi nga banka nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.04.2013, ndërmjet {***} ShPK dhe z. K. K. dhe znj. Manjola Kajana.

17.1. Nga këto prova rezultoi marrja e kredisë nga {***} Fier, me norma normale interesi dhe destinimin e kësaj kredie për blerjen e apartamentit në Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 110,11 m².

18. Në lidhje me pretendimin për gjendjen e konfliktit të interesit me Bashkinë Fier, punonjësit e saj, {***}-në, punonjësit e saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, paraqiti shkresën nr. {***} prot., datë 07.06.2019, të PPGjShPF-së dhe vërtetimet nr. {***} prot., datë 21.02.2020 dhe nr. {***} prot., datë 21.02.2020 të PPGjShPF-së.

18.1. Nga këto prova nuk rezultoi që prokurorja Manjola Kajana, gjatë periudhës që kishte ushtruar funksionin e prokurores pranë PPGjShPF-së, tetor 2009 - prill 2010 dhe shtator 2012 - shtator 2013 të kishte hetuar kallëzime/procedime penale me palë Bashkinë Fier apo punonjës/zyrtarë të saj, si dhe me palë {***}-në, Dega Fier apo punonjës të saj.

19. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga z. K. K., nga punësimi pranë {***} ShPK, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, paraqiti shkresën e datës 19.02.2020, të shoqërisë {***} ShPK, vërtetimin nr. {***} prot., datë 17.01.2017 dhe datë 20.02.2013 të {***} ShPK, si dhe kërkesën për sqarim të datës 26.02.2020 të znj. Manjola Kajana, drejtuar DRT Dibër, në lidhje me: i) urdhërpagesën nr. {***}, tatim i mbajtur në burim për periudhën tatimore korrik 2015, shuma 38538 lekë; ii) urdhërpagesën nr. {***}, tatim i mbajtur në burim për periudhën tatimore dhjetor 2014, shuma 139008 lekë, si dhe iii) dy mandatpagesat e Bankës {***} për shumat respektive.

19.1. Në përmbledhje të këtyre provave, rezultoi e konfirmuar nga punëdhënësi {***} ShPK se z. K. K. kishte punuar në pozicionin e konsulentit ligjor nga data 05.01.2013 deri në datën 31.03.2014, dhe gjatë kësaj periudhe kishte përfituar të ardhura neto në shumën 750000 lekë.

20. Në lidhje me të ardhurat e z. Th. K. dhe znj. M. K., subjekti i rivlerësimit paraqiti përkatësisht vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës (në vijim “DRAPD”), si dhe vërtetimin e datës 21.02.2020 të DRT Durrës, për pensionin e pleqërisë së znj. M. K..

20.1. Nga provat e mësipërme, rezultoi se z. Th. K. kishte përfituar nga DRAPD, të ardhurat në vijim: i) viti 2008 - paga neto 401.637 lekë; ii) viti 2009 - paga neto 486.484 lekë; iii) viti 2010 - paga neto 493.916 lekë; iv) viti 2011 - paga neto 514.390 lekë; v) viti 2012 - paga neto 531.728 lekë; vi) viti 2013 - paga neto 552.062 lekë; dhe vii) viti 2014 - paga neto 32.504 lekë.

20.2. Për znj. M. K., rezultoi se kishte përfituar pension pleqërie nga data 17.08.2000 deri në datën 02.07.2009, në masë fillestare 9623 lekë/muaj, dhe në momentin e mbylljes 18.300 lekë/muaj, nga ku totali i të ardhurave nga pensioni rezultonte të ishte 1.402.543 lekë.

21. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, paraqiti vlerësimet e Prokurorisë së Përgjithshme për vitet 2012 - 2016, certifikatën e sigurimit të DSIK-së, vlerësimet e Shkollës së Magjistraturës për periudhën tetor 2006 - 2009, si dhe urdhrat e komandimit të Prokurorisë së Përgjithshme për vitet 2010 - 2014.

21.1. Në përmbledhje të këtyre provave, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ishte vlerësuar shumë mirë nga Prokuroria e Përgjithshme, ishte pajisur me certifikatën e sigurisë nga DSIK-ja, ishte vlerësuar *shumë mirë* apo *shkëlqyeshëm*, sipas rastit, nga Shkolla e Magjistraturës, ndërkohë që para komandimit në Prokurorinë e Përgjithshme në vitin 2013, kishte ushtruar funksionin e prokurores, kryesisht e komanduar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës (në vijim “PPGjShPD”).

B. Dokumentet e paraqitura në datën 06.03.2020¹⁰

22. Në datën 06.03.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, paraqiti shkresën nr. {***} prot., datë 02.03.2020, të Bashkisë Fier dhe shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2020, të DRT Dibër.

22.1. Për sa më sipër, rezultoi se Bashkia Fier dhe DRT Dibër nuk i kishin pajisur në mënyrë shteruese kërkuesit, përkatësisht z. K. K. dhe znj. Manjola Kajana, me informacionin në lidhje me praktikat administrative të këtyre institucioneve, përkatësisht për vendimin nr. {***}, datë 30.10.2012 të KBF-së dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ana e {***} ShPK, për punësimin e z. K. K., për vitet 2013 - 2014.

¹⁰ Në seancë gjyqësore.

C. Dokumentet e paraqitura në datën 19.03.2020¹¹

23. Në lidhje me denoncimin e paraqitur nga z. T. D., subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj shkresën kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 18.03.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim “GjPAKKO”), së bashku me aktet e fillimit dhe të gjykimit të çështjes që i përkisnin kallëzimit penal nr. {***}, datë 26.07.2019, të z. T. D.. Gjithashtu, në lidhje me denoncimin e paraqitur nga znj. D. M., subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, paraqiti vendimin nr. {***}, datë 29.06.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (në vijim “GjShPKR”), kundër D. M., akuzuar për kryerjen e veprës penale të shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, kërkuese Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (në vijim “PPGjShPKR”) Tiranë, si dhe vendimin nr. {***}, datë 11.09.2015, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda (në vijim “GjAKR”).

23.1. Në përmbledhje të këtyre provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, Kolegjit i rezultoi se ato nuk përmbanin indicie për fakte ose rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana.

24. Pas vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues, datë 06.03.2020, në Kolegj janë administruar në cilësinë e provës shkresore përgjigjet e ardhura përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim “DPT”), Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës (në vijim “PPGjShPD”), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (në vijim “GjRrGjF”), DRT Dibër dhe KBF-ja.

A. Dokumentet e ardhura nga DPT-ja¹²

25. Nga shkresa nr. {***} prot., datë 19.03.2020, e DPT-së, e ardhur në Kolegj në datën 30.03.2020, rezultoi se z. K. K. nuk kishte qenë i deklaruar pranë subjektit {***} ShPK.

B. Dokumentet e ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme dhe PPGjRrGjD¹³

26. Në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesit me {***}-në Durrës, u administrua shkresa nr. {***} prot., datë 25.03.2020, e Prokurorisë së Përgjithshme, e ardhur në Kolegj në datën 25.03.2020, nga e cila rezultoi se prokurorja Manjola Kajana kishte qenë e komanduar në PPGjShPD, gjatë periudhave 01.04.2010 - 31.12.2020, dhe 19.09.2011 - 19.09.2012, dhe se gjatë periudhës së komandimit në PPGjShPD, nuk kishte të regjistruar materiale ku të ishte përfshirë {***}-ja, të cilat të ishin trajtuar nga prokurorja Manjola Kajana.
27. Gjithashtu, nga shkresa nr. {***} prot., datë 19.03.2020, e PPGjShPD, Kolegjit i rezultoi se PPGjShPD nuk kishte të regjistruara materiale ku të përfshihej {***}-ja, të cilat ishin trajtuar nga prokurorja Manjola Kajana.

¹¹ Shih dokumentet e regjistruara sipas inventarit dhe procesverbalit nr. {***} prot., datë 03.03.2020.

¹² Në përgjigje të kërkesës nr. {***}, datë 10.03.2020, të relatorit, të komunikuar me shkresën nr. {***} prot., datë 10.03.2020, të kryetares.

¹³ Në përgjigje të kërkesës nr. {***}, datë 10.03.2020, të relatorit, të komunikuar me shkresën nr. {***} prot., datë 10.03.2020, të kryetares.

C. Dokumentet e ardhura nga GjRrGjF-ja¹⁴

28. Në lidhje me gjendjen e konfliktit të mundshëm të interesit me Bashkinë Fier apo punonjës/zyrtarë të saj, si dhe me palë {***}-në, Dega Fier, apo punonjës të saj, në Kolegj u administrua dosja gjyqësore që i përket vendimit nr. {***}, datë 19.12.2014, të GjRrGjF, në lidhje me akuzat e ngritura kundër punonjësve të Bashkisë Fier për shpërdorim detyre dhe personave të tjerë për falsifikim dokumentesh¹⁵.

28.1. Në përmbledhje të akteve të dosjes penale, Kolegjit nuk i rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, të kishte qenë prokurore e çështjes në ngarkim të punonjësve të Bashkisë Fier.

Ç. Dokumentet e ardhura nga DRT Dibër¹⁶

29. Nga shkresa nr. {***} prot., datë 06.04.2020, e DRT Dibër, rezultoi se kjo e fundit i ishte drejtuar {***} ShPK, me NIPT {***}, për dhënie informacioni të detajuar, në lidhje me punësimin e z. K. K..

29.1. Nga informacioni i dhënë DRT-së Dibër, nga {***} SHPK, rezultoi se z. K. K. kishte pasur një kontratë punësimi, të lidhur më datë 15.01.2013, dhe për një periudhë njëvjeçare pranë këtij subjekti.

29.2. Në vijim, shoqëria {***} ShPK sqaronte se për punën e bërë gjatë viteve 2013 - 2014, në total z. K. K. ishte paguar në shumën 750000 lekë, por se nuk ishte mbajtur tatimi në burim, dhe se tatimi në burim ishte paguar në datën 04.04.2019 nga ky subjekt. Shuma e paguar e detyrimit ishte 93137 lekë tatim në burim, dhe meqë pagesa e këtij detyrimi ishte bërë me vonesë nga {***} ShPK, u pagua edhe gjoba dhe kamatëvonesa në shumën 45871 lekë për këtë detyrim.

D. Dokumentet e ardhura nga Bashkia Fier

30. Në Kolegj u administrua gjithashtu edhe shkresa nr. {***} prot., datë 29.04.2020, e Bashkisë Fier, si dhe shkresa nr. {***} prot., datë 01.07.2020 e KBF-së.

30.1. Në përmbledhje të këtyre provave, Kolegjit i rezultoi se, referuar vendimmarrjes së KBF-së dhe miratimit të vendimit nr. {***}, datë 30.12.2012, pranë Zyrës së Arkiv Protokollit të Bashkisë Fier, nuk disponohej asnjë dokumentacion mbi miratimin e z. K. K. në listën emërore të familjeve të pastreha.

31. Në vijim, duke i analizuar në tërësi vërtetimet e Prokurorisë së Përgjithshme, PPGjShPD-së, PPGjShPF-së dhe fashikujt gjyqësorë të GjRrGjF-së, rezulton se subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të funksionit të prokurores pranë këtyre prokurorive, ka kryer detyrën në përputhje me parimin e paanësisë dhe duke mos u gjendur në asnjë rast në kushtet e konfliktit të interesit,

¹⁴ Në përgjigje të kërkesës nr. {***} datë 10.03.2020 të Relatorit, të komunikuar me shkresën nr. {***} prot. datë 10.03.2020 të kryetares.

¹⁵ I cili është lënë në fuqi me vendimin nr. {***} datë 14.09.2016({***}) të Gjykatës së Apelit Vlorë.

¹⁶ Në përgjigje të kërkesës nr. {***} datë 10.03.2020 të Relatorit, të komunikuar me shkresën nr. {***} prot. datë 10.03.2020 të kryetares.

përkatësisht me Bashkinë Fier apo zyrtarët e saj, {***}-së apo zyrtarët e saj, apo edhe EKB-në apo zyrtarët e saj.

31.1. Rezultoi se familja e subjektit të rivlerësimit që në momentin e privatizimit të banesës në Durrës, përbëhej nga 3 persona të rritur, që përbënin 2 kurorë/familje, të cilët banonin në një apartament me strukturë garsionerë, me sip. banimi prej 17 m², dhe se mbështetur në pikën 4 të ligjit nr. 9232/2004, banesa në Durrës nuk i plotësonte nevojat për strehim dhe familjes së z. K. K. i lindte e drejta për të aplikuar për strehim.

31.2. Gjithashtu, Kolegji, vlerëson se mungesa e dokumentacionit pranë Zyrës së Arkiv Protokollit të Bashkisë Fier, si pasojë e veprimeve të këtij organi publik, nuk sjell pasoja për subjektin e rivlerësimit.

32. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”), në nenin 13 ka parashikuar procedurat e veçanta, sipas të cilit: “Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime, që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar”.

33. Rrethanat të cilat mund të dëshmojnë konfliktin e mundshëm të interesit, për magjistratët prokurorë janë parashikuar me referim nga neni 3/ç, pika 1 e ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikonte se: “1. Drejtuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor, drejtuesit të prokurorisë pranë gjykatës së apelit, prokurorit të apelit, prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme apo Prokurorit të Përgjithshëm, kur gjendet në një çështje penale në rastet e parashikuara në nenet 16 e 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, i ndalohet t'i japë urdhra dhe udhëzime, me shkrim, prokurorit të çështjes apo të ndikojë në çdo mënyrë tjetër”.

33.1. Neni 16 i KPrPenale parashikonte se: “1. Në të njëjtin procedim nuk mund të marrin pjesë si gjyqtarë personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim, bashkëshortë, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave) ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjuhërrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka)”.

33.2. Ndërsa neni 17, pika 1 e KPrPenale, parashikonte se: “1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a). kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, ose i fëmijëve të tij; b). kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij; c). kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit; ç). kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërit prej palëve private; d). kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale; dh). kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim; e). kur ndodhet

në një nga kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”.

34. Konflikt i mundshëm i interesit, është gjendja kur interesat personale ndikojnë te magjistrati për të ushtruar funksionin në mënyrë të paanshme dhe me një përkujdesje të zakonshme. Në çështjet gjyqësore, testi i konfliktit të interesit duhet të përfshijë jo vetëm konfliktet ekzistuese, por edhe ato të mundshme¹⁷.
35. Nga provat e administruara në Kolegj, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, të ketë ushtruar funksionin e prokurores, e gjendur në kushtet e konfliktit të interesave, pasi nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë ushtruar funksionin në PPGjShPF apo në PPGjShPD, e gjendur në kushtet e papajtueshmërisë për arsye lidhjeje familjare, gjinie apo krushqie, në kuptim të nenit 16 të KPrPenale, dhe as të jetë gjendur para kushteve për të hequr dorë nga çështja, në kuptim të nenit 17 të KPrPenale.
- 35.1. Si pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit, sikurse edhe Komisioneri në pretendimet përfundimtare parashitroi se nuk rezultonte që prokurorja Manjola Kajana të kishte kryer ndonjë veprim procedural në lidhje me hetimin e zyrtarëve të Bashkisë Fier, si dhe nuk kishte mbajtur detyrën e prokurorit drejtues/më të lartë, teksa bashkëshorti i saj listohet për të përfutuar nga kjo bashki një kredi me kushte lehtësuese për familjet e pastreha.
36. Në bisedimet përfundimtare, Komisioneri¹⁸ parashitroi se subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, gjatë periudhës 2012 - 2014, nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së magjistratit prokuror në PPGjShPF dhe, si pasojë, nuk kishte cenuar etikën profesionale në kryerjen e detyrës¹⁹. Në lidhje me shkaqet e tjera të ankimit, pas hetimit të kryer nga Kolegji, Komisioneri Publik parashitroi se plotësimi i kriterëve të aplikimit dhe pamjaftueshmëria financiare në vlerën 115.000 lekë, si të ndërvarura me shkakun parësor të mësipërm, që lidhej me etikën dhe rivlerësimin profesional të magjistratit, në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, nuk provoheshin të ishin të tillë, që të shërbenin si shkaqe për marrjen e masës së shkarkimit.
37. Në vijim të analizës së mësipërme, pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, akteve shkresore të sjella prej saj, atyre të administruara gjatë procesit në Kolegj dhe pretendimeve të Komisionerit, Kolegji vlerëson si shkak parësor ankimi konfliktin e interesit, dhe të ndërvarura me konfliktin e interesit shkaqet e tjera, duke arritur në të njëjtin konkluzion me Komisionerin, se vendimi nr. 162, datë 19.06.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet të lihet në fuqi.

¹⁷ Shih paragrafin 67 të Komentarit mbi Parimet Bangalore të Veprimtarisë Gjyqësore.

¹⁸ Në referencë të shkakut parësor për hetim në drejtim të konfliktit të interesit në aktet e dosjes penale të GjRrGjF-së, vendimi nr. {***}, datë 28.05.2015.

¹⁹ Ky përfundim, sipas Komisionerit, bazohet në verifikimin e akteve të dosjes gjyqësore të administruar gjatë gjykimit nga ky trup gjykues, prej nga prokurorja Manjola Kajana nuk rezultonte të kishte kryer ndonjë veprim procedural në lidhje me hetimin e zyrtarëve të Bashkisë Fier, si dhe nuk kishte mbajtur detyrën e prokurorit drejtues/më të lartë, teksa bashkëshorti i saj listohet për të përfutuar nga kjo bashki një kredi me kushte lehtësuese për familjet e pastreha.

37.1. Lidhur me pretendimin e Komisionerit mbi burimet e ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për krijimin e pasurisë apartament 110,11 m², ndodhur në Tiranë, për një vlerë negative rreth 115.000 lekë, Komisioni ka arritur në përfundimin se “deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe për rrjedhojë çmon se deklarimi i tij është i saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016”²⁰.

37.2. Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në bisedimet përfundimtare, datë 07.07.2020, diferenca negative në krijimin e depozitave në *cash* në {***} Bank, *ishte pasojë e moslogaritjes së gjendjes cash të një shume parash të kursyera nga babai i bashkëshortit, z. Th. K., të cilat ia kishte dhënë djalit të tij, me qëllim që kur të privatizohej garsionera, të përdoreshin edhe këto shuma të kursyera nga z. Th. K.* Subjekti i rivlerësimit pretendoi se këto të ardhura e kishin burimin nga punësimi si mësues shkolle, të cilat kishte pasur mundësi t’i kursente, por se nuk kishte detyrim për t’i deklaruar në deklaratat vjetore. Këto të ardhura, vijon subjekti i rivlerësimit, që janë deklaruar në deklaratën *vetting*, i janë dhënë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, i cili i ka depozituar më pas në Bankën {***}.

37.3. Kolegjit, pasi mori në shqyrtim aktet që gjenden në dosje, si dhe vërtetimin e punësimit të z. Th. K.²¹ për periudhën 2008 - 2010, i rezultoi se z. Th. K. kishte përfituar të ardhura në total prej 1382037 lekësh, duke konsideruar shpenzime jetese vetëm për të (si familje me një person) shumën prej 409860 lekësh.

37.4. Rezulton se z. Th. K. ka pasur mundësinë të kursente të paktën shumën sa diferenca negative, por dhe më shumë.

37.5. Në këto kushte, ashtu sikurse edhe Komisioneri parashtroi në bisedimet përfundimtare, nuk përbën shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, përkundrazi Kolegjit nuk i rezultoi me diferenca negative, duke konsideruar pretendimet e subjektit në bisedimet përfundimtare të trajtuara më sipër.

37.6. Gjithashtu, në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të z. K. K. nga punësimi pranë {***} ShPK, Komisioni ka arritur në përfundimin se: “Sipas kontratës individuale të depozituar, rezulton se kontributet mbi të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit do të derdheshin nga punëdhënësi. Sipas *statement-it* bankar, Komisioni konstatoi se pagat e bashkëshortit të subjektit, në shumën 50000 lekë, ishin kaluar çdo muaj në sistemin bankar nga punëdhënësi, ndërsa u konstatua se nuk ishin paguar kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për këtë periudhë punësimi. Mbi këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit depozitoi pagesat e kryera nga punëdhënësi në datën 5 prill 2019, sipas urdhërpagesave mbi tatimin e mbajtur në burim, për periudhën tatimore dhjetor 2014 dhe korrik

²⁰ Shih f. 6, pika 1.2.12 e vendimit nr. 162, datë 19.06.2019, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

²¹ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës (në vijim “DRAPD”), për z. Th. K., viti 2008 - paga neto 401.637 lekë, viti 2009 - paga neto 486.484 lekë, viti 2010 - paga neto 493.916 lekë, viti 2011 - paga neto 514.390 lekë, viti 2012 - paga neto 531.728 lekë, viti 2013 - paga neto 552.062 lekë, viti 2014 - paga neto 32.504 lekë. Aktet e sjella nga subjekti në seancën e datës 03.03.2020.

2015, përkatësisht në shumat 139008 lekë dhe 38538 lekë. Në këto kushte, Komisioni i përfshiu këto të ardhura në analizën financiare”²².

37.7. Në vijim të pretendimit të Komisionerit Publik në ankimin e datës 02.08.2019, në paragrafin 18.1.7, në faqen 15 të tij: *këto të ardhura, nuk duhet të llogariteshin nga ana e Komisionit si burime të ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, dhe bashkëshortit të saj*, Kolegji kreu analizën financiare për vitet 2013 dhe 2014, vite kur personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, ka përfituar të ardhurat nga punësimi në shoqërinë {***} ShPK.

37.8. Në përfundim, në përgjigje të pretendimit të Komisionerit në ankim, në paragrafin 18.1.7, në faqen 15 të tij, nga analiza e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, mbulonte me burime të ligjshme nga të ardhura të dokumentuara pasuritë, shpenzimet dhe likuiditetet e krijuara në vitet 2013 dhe 2014, duke mos i konsideruar të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga {***} ShPK.

V. Denoncime

38. Pas verifikimit të denoncimeve të z. T. D. dhe znj. D. M., Kolegji konstatoi se ato nuk përmbanin indicie për fakte ose rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana.
39. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi administroi në cilësinë e provës aktet e administruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga institucionet e ndryshme shtetërore në funksion të hetimit gjyqësor, dhe pas verifikimit të denoncimeve nga publiku, vendosi mbylljen e shqyrtimit gjyqësor për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana.
40. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi dëgjoi edhe bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, në përfundim të hetimit gjyqësor vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit të prokurores në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Nga vlerësimi në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes, nuk rezultuan indicie për pamjaftueshmëri burimesh në drejtim të justifikimit të pasurive, duke arritur kështu nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 49 dhe 59 të ligjit nr. 84/2016. Në konkluzion të sa më sipër, Kolegji arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

²² Shih f. 8, pika 1.4 e vendimit nr. 162, datë 19.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 162, datë 19.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, në Tiranë, më datë 10.07.2020.

ANËTAR

Ardian Hajdari

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Luan DACI

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi